



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:223274

Datë: 08.07.2021

Numri i dokumentit: 01976666

C.nr.2721/15

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Nexhat Qallapeku, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.B nga Prishtina, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Avokatura MBN Sh.P.K, me përfaqësues Mexhid Syla, Blerim Syla dhe Nexhat Syla, avokat në Prishtinë, Rruga “UÇK”, Hyrja 261, Kati i I-rë, numër 5, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “K.....”, me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Hamdi Azemi, jurist pranë të paditurës, me objekt të kontestit kompensim i dëmit, vlera e kontestit 13,600.00€, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor publik të datës 07.06.2021, të mbajtur me prani të përfaqësuesve të palëve ndërgjyqëse, me datë 18.06.2021 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditësit B.B nga Prishtina.

II. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “K.....” me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material të pësuar në aksidentin e shkakuar me datë 13.07.2015, t’ia paguaj shumat si vijon:

Në emër të dëmit jo material:

- Për dhimbje trupore - fizike, shumën prej 2,850.00€
- Për friken e pësuar, shumën prej 1,995.00€
- Për zvogëlimin të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 1,350.00€

Në emër të dëmit material:

- Për ushqim të përforcuar, shumën prej 200.00€
- Për përkujdesje të personit të huaj, shumën prej 200.00€

III. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “K.....” me seli në Prishtinë, që paditësit

prestimet si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, t'ia paguaj me kamatë ligjore prej 8% në vit, dhe atë për dëmin material nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë (13.11.2015), kurse për dëmin jo material nga data e marrjes së këtij aktgjykimi (18.06.2021) e deri në pagesën e tërësishme, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim.

IV. REFUZOHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, mbi shumat e aprovuara si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, dhe atë: për dhimbje trupore - fizike shuma prej 1,150.00€, për friken e pësuar shuma prej 1,005.00€, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shuma prej 4,650.00€ dhe për rehabilitim klimaterik shuma prej 200.00€ si dhe kërkesat e paditësit për aplikimin e kamatëvonesës prej 12% në vit.

V. DETYROHET e paditura që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 654.40€, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim. Refuzohet kërkesa e paditëses për kompensimin e shpenzimeve të procedurës mbi shumën e gjykuar, në shumë prej 582.40€.

A r s y e t i m

Paditësi B.B nga Prishtina, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, me datë 13.11.2015, në këtë Gjykatë ka ushtruar padi, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “K.....”, me seli në Prishtinë, për kompensim e dëmit.

Përfaqësuesi i paditësit në padi, përgjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare ka theksuar se me datë 13.07.2015, në Lagjen Emshir, afër Gardenit në Prishtinë, është shkaktuar fatkeqësi komunikacioni, me fajin e automjetit A me numër të targave 01..., i cili duke mos mbajtur distancën e duhur të sigurisë në mes të automjeteve, godet automjetin nën B me numër të targave 01... dhe si pasojë e kësaj goditje, lëndime trupore ka pësuar paditësi B.B, për çka ka kërkuar edhe ndihmë mjekësore. Më tej thekson se si pasojë e këtyre lëndimeve, paditës ka përjetuar dhimbje fizike të të gjitha intensiteve, ka pësuar edhe frikë primare të të gjitha intensiteve, zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallë prej 3% dhe pasi që baza juridike nuk është kontestuese, konsiderojmë se shumat e kërkuara për të gjitha llojet e kompensimit janë reale, tërësisht të bazuara në provat e administruara, në pajtim me dëmin e pësuar dhe me praktikën gjyqësore. Andaj mbi bazën e kësaj i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, ashtu që ta detyroj të paditurën që

paditësit t'ia paguaj kompensimin: në emër të dëmit jomaterial – në emër të dhimbjeve fizike shumë prej 4,000.00€, në emër të frikës shumë prej 3,000.00€, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumë prej 6,000.00€. Kurse në emër të dëmit material shumë: në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj shumë prej 200.00€, në emër të ushqimit të përforcuar shumë prej 200.00€ dhe në emër të rehabilitimit fizioterapeutik shumë prej 200.00€, apo shumë e përgjithshme (të dëmit jomaterial dhe material) 13,600.00€, me kamatë prej 12% për dëmin jomaterial, nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit, kurse për dëmin material nga data e paraqitjes së kërkesës për kompensim të dëmit pranë të paditurës, e deri në pagesën përfundimtare.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë: për padi shumë prej 208.00€, për përfaqësim në dy seanca gjyqësore shumë prej 540.80€ (dy seanca nga 270.40€), për precizimin e kërkesëpadisë shumë prej 208.00€, për taksë gjyqësore shumë prej 40.00€ dhe për ekspertizë mjekësore shumë prej 240.00€.

E paditura në përgjigje në padi, në seancat gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare, përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar, nuk e ka kontestuar bazën juridike të kërkesëpadisë, por ka kontestuar kërkesëpadinë vetëm për nga lartësia, për dëmin material dhe jo material, me pretendimin se shumë e kërkuara janë të pabazuara dhe të pa justifikuar si dhe në kundërshtim të plotë me praktikën gjyqësore. Ka shtuar se, me që është vërtetuar se në këtë rast paditësit i janë shkaktuar lëndime trupore, kërkesëpadija duhet të refuzohet përtej shumë prej 2,500.00€, për të gjitha llojet e dëmit, të ofruara nga kompania në seancën e shqyrtimit kryesor. Lidhur me kamatën mbi shumë e aprovuara nga gjykata, gjykata duhet të vendos të jetë në lartësi si për mjetet e deponuara në bankat afariste në afat njëvjeçar. Ka propozuar që shpenzimet e procedurës të njihen vetëm shpenzimet suksesit në procedurë.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në këtë çështje juridike, Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor - në procedurën e provave, sipas propozimit të palëve ka administruar provat relevante dhe atë: raporti i aksidentit datës 13.07.2015 me numër 2015-AR-1623, Thirrjen për ndihmë të shpejtë mjekësore të datës 13.07.2015, fletëlëshimin me numër të amzës 5502, të përpiluar nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës - Klinika e Neurokirurgjisë dhe ekspertizën mjekësore të datës 25.01.2021, të punuar nga ekspertët Milazim Haxholli – Ortoped dhe Shpend Haxhibeqiri – Psikiatër.

Mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se me datën 13.07.2015, kishte ndodhur aksident komunikacioni mes automjetit me numër të targave 01.....dhe automjetit 01....., e si pasojë e këtij aksidenti lëndime kishte pësuar këtu paditësi B.B, i cili në kohën e aksidentit

gjendej në automjetin 01....., fakt që provohet edhe me raportin e aksidentit numër 2015-AR-1623, të datës 13.07.2015, të përpiluar nga Policia e Kosovës.

Po ashtu mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues as fakti se shkaktar i aksidentit të komunikacionit, nga ka rrjedhur edhe dëmi, ka qenë i siguruar tek e paditura, me policën e sigurimit numër 0005323179, e vlefshme deri më 09.01.2016.

Çështje kryesore kontestuese mes palëve ndërgjyqëse mbetet lartësia e kompensimit, për të cilën përfaqësuesit e palëve ndërgjyqëse kanë paraqitur argumente të ndryshme mes tyre.

Nga Raporti i Policisë i datës 13.07.2015, numër 2015-AR-1623, konstatohet se deri tek aksidenti i komunikacionit ka ardhur kur vozitësi i automjetit Renault Clio, me numër të targave 01.....duke mos iu përmbajtur rregullave të komunikacionit rrugor, mos mbajtja e distancës së mjaftueshme, në pjesën e pasme godet veturën e markës VW, passat, me numër të targave 01..... Si pasojë e goditjes, lëndime pësojnë dy persona, njëri prej tyre tani paditësi B.B.

Gjykata gjeti se paditësi me datë 13.07.2015, pra ditën e ndodhjes së aksidentit, është paraqitur në Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës – Klinikën e Neurologjisë, për të kërkuar ndihmë mjekësore. Në këtë klinikë paditësi ka qëndruar i shtrirë nga data 13.07.2015 deri me datën 16.07.2015, kjo bazuar në fletlëshimin me numër të amzës 5502, në të cilit evidentohen lëndimet e pësuar nga paditësi dhe tretmani mjekësor që ka pranuar.

Për të përcaktuar natyrën dhe shkallën e lëndimeve në këtë aksident trafiku, gjykata, me propozimin e palës paditëse, ka nxjerrë provën përmes ekspertizës, me ekspertë nga lëmia e ortopedisë dhe psikiatrisë.

Eksperti ortoped, Milazim Haxholli, në bazë të ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor, i cili gjendet në shkresat e lëndës, dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit, ka konstatuar se paditësi, si pasojë e aksidentit të shkaktuar ka pësuar lëndime trupore, që cilësohen si lëndime të rënda trupore. Paditësi si pasojë e lëndimeve të marra ka pësuar dhimbje fizike të intensiteteve të ndryshme, si shkak i lëndimeve trupore: ndrydhje truri, tronditje trunore, dhimbje koke, ndrydhje qafe, ndrydhje në veshin e djathtë dhe lëndim i kanaleve të veshit të djathtë. Dhimbje me intensitet posaçërisht të rëndë ka pasur disa sekonda, deri në humbjen e vetëdijes. Dhimbje të intensitetit të rëndë ka pasur 2 ditë, që manifestohen për shkak të tronditjes trunore, lëndimit të veshit, qafës, e të cilat përcillen me dhimbje, përkundër marrjes së terapisë kundër dhimbjes. Paditësi ka pasur dhimbje me intensitet të mesëm në kohëzgjatje prej 30 ditësh, kurse dhimbjet me intensitet të ulët vazhdojnë edhe sot.

Lidhur me nevojën për ndihmën e personit të tretë, eksperti ortoped ka paraqitur se ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 30 ditë, për kryerjen e aktiviteteve të përditshme jetësore si veshja, zhveshja, higjiena personale, kryerja e nevojave të rregullta fiziologjike, lëvizja me mjete ndihmëse ose pa to, kontrollat e rregullta specialistike, pasi këto nevoja nuk ka mundur t'i plotësoj vetë, si pasojë e paaftësisë së plotë dhe të pjesëshme të shkaktuar nga lëndimet e shumëfishta trupore, sidomos ato në kokë. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 30 ditë, i pasuruar me proteina, minerale, vitamina, karbohidrate të nevojshme për ngjitjen dhe sanimin e lëndimit si dhe reaksionit post traumatik. Eksperti ka konstatuar se për paditësin ka qenë i nevojshëm edhe rehabilitimi fiziatriko – psikik, në kohëzgjatje për 15 ditësh. Po ashtu, eksperti ka gjetur se paditësi ka pësuar zvogëlim të aktiviteti të përgjithshme jetësor në shkallë prej 3%, kurse nuk ka pësuar shëmtim trupor.

Eksperti i psikiatrisë, Shpend Haxhibeqiri, në bazë të ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor i cili gjendet në shkresat e lëndës dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit, ka konstatuar se paditësi, si pasojë e aksidentit të shkaktuar ka përjetuar frikë sekondare, por nuk ka përjetuar frikë primare nga se nuk ka arritur ta shoh momentin e përplasjes. Frikë sekondare të intensitetit të lartë ka përjetuar në kohëzgjatje prej 3 ditëve, frikë sekondare të intensitetit të mesëm ka përjetuar në kohëzgjatje prej 1 muaji, kurse frikë sekondare të intensitetit të ulët ka përjetuar në kohëzgjatje për 1 muaj.

Gjykata të dy ekspertizat mjekësore atë të ortopedisë dhe psikiatrisë, i ka pranuar në tërësi si të besueshme, me që të njëjtat ishin profesionale dhe të argumentuara, po ashtu e punuar sipas vëllimit të përcaktuar, duke ofruar të dhëna lidhur vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore.

Gjykata për vendosjen e kësaj çështje juridike kontestimore u bazua në Ligjin Nr.04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia, Ligjin Nr.04/L077 për marrëdhëniet e detyrimeve, e posaçërisht në dispozitat në vijim.

Me nenin 9, paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia, është përcaktuar mbulesa siguruese, ashtu që sigurimi nga auto përgjegjësia mbulon dëmet në persona dhe pasuri të shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i mjetit motorik. Kurse me nenin 10 të tij përcaktohet e drejta për kompensim për dëmin material dhe jo matrial, i cili duhet të bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve.

Ligji Nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, rregullon çështjen e kompensimit të dëmit (material dhe jo material), ashtu që me nenin 136, paragrafi 1 është përcaktuar se kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është

shkaktuar pa fajin e tij. Me nenin 140 përcaktohet se “fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia.” Kurse me nenin 159, të po të njëjtit ligj, përcaktohet se “në rast aksidenti të shkaktuar nga mjeti motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat mbi përgjegjësinë në bazë të fajësisë”.

Me nenin 137 të të ligjit në fjalë (LMD) përcaktohet se “Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”. Kurse me dispozitën e nenit 183, paragrafi 1, të po të njëjtit ligj, përcaktohet se për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material.

Bazuar në dispozitat ligjore të sipërcituara, gjykata gjen se pala e paditur është përgjegjëse për kompensimin e dëmit të pësuar nga pala paditëse, pasi që shkaktues i dëmit ka qenë i siguruari tek e paditura dhe në këto rrethana, kompensimi i palës së dëmtuar në aksident bëhet mbi bazën e sigurimit nga auto përgjegjësia, konform nenit 136 dhe 159 të Ligjit Nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve dhe nenit 9, paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia

Prandaj, gjykata duke u bazuar në këto dispozita si dhe duke i vlerësuar të gjitha kriteret dhe masat për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit jomaterial, posaçërisht duke marr parasysh natyrën dhe shkallen e dëmtimeve trupore të shkaktuara paditësit, vlerësimin në ekspertizave mjekësore, miratoj pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, në vlerën e shpërblimit të dëmit si në piken II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata, në emër të dhimbjeve fizike, aprovoi kërkesëpadinë në shumë prej 2,850.00€,si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit, sepse paditësi sipas mendimit të ekspertit ortoped, si pasojë e aksidentit dhe lëndimeve të pësuar prej tij, ka përjetuar dhimbje me intensitet posaçërisht të rëndë ka pasur disa sekonda, dhimbje të intensitetit të rëndë 2 ditë, dhimbje me intensitet të mesëm në kohëzgjatje prej 30 ditësh, kurse dhimbjet me intensitet të ulët vazhdojnë edhe sot.

Në emër të kompensimit lidhur me frikë për paditësin, gjykata ka caktuar shpërblimin në shumë prej 1,995.00€, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse paditësi, sipas mendimit të ekspertit të psikiatrisë, ka përjetuar frikë sekondare të intensitetit

të lartë 3 ditë, frikë sekondare të intensitetit të mesëm 1 muaj dhe frikë sekondare të intensitetit të ulët 1 muaj.

Në emër të kompensimit për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor, gjykata ka caktuar kompensimin në shumë prej 1,350.00€, duke pasur parasysh moshën e paditësit në kohën e aksidentit dhe shkallën e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor të paditësit si pasojë e aksidentit të komunikacionit, zvogëlim ky që sipas mendimit dhe konstatimit të ekspertit mjekësor, është 3%.

Gjykata, vlerëson se shumat e kompensimit për dëmin jomaterial, të aprovuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi janë adekuate, duke marr parasysh dëmin që i është shkaktuar paditësit dhe se lartësia e shumës së të hollave në emër të kompensimit, do t'i mundësoj paditësit satisfaksion që të jetë në gjendje që deri në një masë, t'i kompensoj të mirat jo materiale nga të cilat është privuar, respektivisht atë shkallë të satisfaksionit të cilën ai do ta kishte po që se i njëjti nuk do t'i kishte humbur, si dhe duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e lëndimeve të pësuar, intensitetin e dhimbjeve dhe të frikës, kohëzgjatjen e tyre, kohën e nevojshme të shërimit dhe shkallën e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor. Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi shpërblimin e dëmit jomaterial, si dhe në lidhje me shumën kompensimit të këtij dëmi, mes tjerash gjykata ka pasur parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cili i shërben ky kompensim, siç përcaktohet me nenin 183 të Ligjit Nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve.

Gjykata, në emër të dëmit material për ushqim të përforcuar dhe ndihmë e kujdes të huaj, ka aprovuar shumat si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në kërkesëpadinë e paditësit dhe nenin 179, paragrafi 1 të Nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, ku është përcaktuar se “kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit.” Në këtë rast paditësit i takon e drejta në kompensim të këtij lloji të dëmit material, për ushqim të përforcuar dhe kujdesin e huaj, përkundër faktit se paditësi për këto kategori të dëmit nuk ka prezantuar prova konkrete materiale. Gjykata, vlerëson se paditësit i takon ky kompensim, duke u bazuar edhe në praktikën e gjerë tanishme gjyqësore, ku është konstatuar se në shumicën dërmuese të rasteve, palët e kanë të pamundur apo shumë të vështirë të sigurojnë dëshmi për këtë lloj kompensimi, pasi që kryesisht kujdesin ndaj të dëmtuarve e bëjnë familjarët e tyre dhe ushqimi i përforcuar, i cili përfshinë ushqim shtesë të ushqimit të zakonshëm, është vështirë të argumentohet me prova konkrete. Këto kategori të kompensimit, janë të njohura edhe me Rregullore për përcaktimin e kritereve për vlerësimin e dëmeve

jomateriale nga auto përgjegjësia, e cila nuk është obliguese për gjykatat në rastin e vendosjes, por mund të merret si kriter orientues, rezulton se kompanitë e sigurimeve në rastet e aksidenteve të komunikacionit, të dëmtuarve u njohin të drejtën në kompensimin e dëmit për ushqim të përforcuar dhe për kujdesin dhe ndihmën e huaj nga personi i tretë.

Gjykata, në emër të ushqimit të përforcuar për paditësin, ka caktuar kompensimin në shumën nga 200.00€, brenda kufijve të kërkesëpadisë, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse sipas mendimit të ekspertit ortoped, si pasojë e aksidentit, paditësi ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 30 ditë, i pasuruar me proteina, minerale, vitamina, karbohidrate të nevojshme për ngjitjen dhe sanimin e lëndimit si dhe reaksionit post traumatik.

Në emër të kujdesit dhe ndihmës së huaj nga personi i tretë, gjykata ka caktuar kompensimin në shumën nga 200.00€, brenda kufijve të kërkesëpadisë, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse sipas mendimit të ekspertit ortoped, si pasojë e aksidentit, paditësi në kohëzgjatje prej 30 ditësh ka pasur nevojë për këtë ndihmë dhe kujdes nga personi i tretë për kryerjen e aktiviteteve të përditshme jetësore si veshja, zhveshja, higjiena personale, kryerja e nevojave të rregullta fiziologjike, lëvizja me mjete ndihmëse ose pa to, kontrollet e rregullta specialistike, pasi këto nevoja nuk ka mundur t'i plotësoj vetë, si pasojë e paaftësisë së plotë dhe të pjesshme të shkaktuar nga lëndimet e shumëfishta trupore, sidomos ato në kokë.

Gjykata, ka vendosur si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për refuzimin e kërkesëpadisë që ndërlidhet me dëmin jomaterial, pasi që vlerësoj se kompensimi përtej shumës së gjykuar nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllimin që kompensimi të ishte i drejtë. Kurse sa i përket dëmit material, gjykata ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit sa i përket rehabilitimit fizioterapeutik klimatik, sepse nuk janë ofruar prova mbi bazën e të cilave do të provoheshin shpenzimet e bëra për qëllime të këtij kompensimi të pretenduar. Bazuar në dispozitën e nenit 322 të Ligjit Nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, paditësi ka pasur barrën e provës për të provuar këtë shpenzim, i njëjti nuk ka provuar shpenzimet e bëra për këtë kategori të kompensimit.

Në lidhje me kamatën ligjore që duhet ta paguaj i padituri për shumën e aprovuar në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata vendosi bazuar nenin 382 të Ligjit Nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, sipas të cilit “debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhi të kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8 %) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”. Kamata për dëmin material, në larësi prej 8% në vit, fillon të rrjedh nga data e ushtrimit të padisë në gjykatë,

përkatësisht nga data 13.11.2015, kurse për dëmin jo material nga data e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, përkatësisht data 18.06.2021, e gjerë në përmbushjen e plotë të detyrimit.

Gjykata ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëseve për njohjen e kamatës në lartësi prej 12% në vit, pasi që paditësi nuk ka ofruar prova materiale me të cilat do të provonte datën e paraqitjes së kërkesës pranë të paditurës për kompensimin e dëmit të shkaktuar në aksidentin e datës 17.03.2015, e në bazë të të cilës do të provohej fakti nëse pala e paditur nuk ka respektuar afatet ligjore nga neni 26, paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia për trajtimin e kërkesën dhe të njoftimin me shkrim të palës së dëmtuar për ofertën dhe refuzimin eventual të kërkesës. Me dispozitën e nenit 322, paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-006 për procedurën kontestimore është përcaktuar se pala që pretendon se i takon një drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër. Andaj në rastin konkret, pala paditëse ka pasur barrën e provës që të provoj faktin e paraqitjes së kërkesës (datën) pranë të paditurës për kompensimin e dëmit, e në bazë të cilit do të përllogaritej afati kohor 15 ditor dhe 60 ditor për trajtimin dhe vendosjen në kërkesën e palës së dëmtuar. Mbi bazën e kësaj, gjykata vlerëson se në këtë rast nuk mund të zbatohen dispozitat e nenit 26, paragrafi 6 të Ligjit Nr.04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia për lartësinë e interesit në 12% mbi shumën e aprovuar të kërkesëpadisë, nga se nuk është provuar vonesa eventuale e palës së paditur në trajtimin e kërkesës së palës së dëmtuar, andaj duhet të zbatohen dispozitat e Ligjit Nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, ku në nenin 382, është përcaktuar lartësia e kamatëvonesës prej 8% në vit.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e neneve 449 dhe 452 të LPK-së, sipas të cilave paditësit i pranohen shpenzimet në shumën e përgjithshme prej 654.40€, dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumën prej 104.00€, për pjesëmarrje në dy seanca gjyqësore të mbajtura shumën 270.40€ (2 seanca nga 135.20 euro), për taksë gjyqësore për padi shumën prej 40.00€ dhe për ekspertiza mjekësore shumën prej 240.00€. Të gjitha këto bazuar edhe në Rregulloren për Tarifat e Odës së Avokatëve të Kosovës të datës 18.03.2017, përkatësisht tariforit 6 dhe 7.

Gjykata nuk ka njohur shpenzimet mbi shumën prej 654.40€, kjo bazuar në paragrafin 5 të nenit 452 të LPK-së, nga se shuma e aprovuar e kërkesëpadisë nga gjykata është nën vlerën 10,000.00€, avokati ka përfaqësuar 1 paditës, ashtu që për përpilim të padisë dhe për përfaqësimin e paditësit në dy seanca gjyqësore, paditësit i takojnë shpenzimet e procedurës në lartësi të cekura si më lartë. Andaj gjykata ka refuzuar kërkesën e paditësit për njohjen e shpenzimeve si në vijim: për përpilim të padisë shumën 104.00€, për përfaqësimin e paditësit

në dy seanca gjyqësore shumë prej 270.40€ dhe për precizimin e kërkesëpadisë shumë prej 208.00€, të dorëzuar në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 07.06.2021. Kompensimi për precizimin e kërkesëpadisë është konsumuar me shpenzimet e njohura për padi dhe se parashtrës në fjalë ka të bëjë me rregullimin e padisë në kuptimin objektiv. Shuma e shpenzimeve të refuzuara, pas mbledhjes së shpenzimeve të specifikuara, është 582.40€.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.2721/15, datë 18.06.2021

Gjyqtari

Nexhat Qallapeku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të tij, Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.